



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 851/1 prot.

Tiranë më 19.6.2018.

**VENDIM**

Nr. 24, datë 19.6.2018

**PËR**

**URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi, Z. \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 851 Prot., datë 10.05.2018, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën e datës 18.04.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me:

1. Kopjen e kallëzimit të Drejtorisë Juridike të FSDKSH-së, dorëzuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Nr. 1821 Prot., datë 14.04.2016, me objekt: Kallëzim të kryerjes së veprës penale të “Mashtrimit”, “Mashtrimit në subvencione” dhe “Falsifikim të Dokumenteve Shëndetësore”.
2. Korrespondencën e FSDKSH-së me Prokurorinë me shkresën Nr. 2708/1 Prot., datë 17.06.2016.
3. Vendimin e pushimit të procedimit penal për kallëzimin e FSDKSH-së të dorëzuar me datë 14.04.2016.

Me shkresën nr. 2019/1 Prot., Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje lidhur me pikën e tretë të kërkesës duke i vënë në dispozicion kërkuesit vendimin e pushimit të anonimizuar, si dhe duke sqaruar ndër të tjera se: “Informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar në pikat 1

*dhe 2 e kërkesës nuk mund të vihet në dispozicion pasi nuk përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Në aktet e kërkuara ka të dhëna me karakter personal të personave të përfshirë në hetim. Dokumentacioni i kërkuar ka për objekt akte procedurale, të cilat rregullohen nga ligji 89/2017 “Kodi i Procedurës Penale”, më konkretisht në nenin 103 të tij është parashikuar se: Ndalohet publikimi, qoftë dhe i pjesshëm i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose vetëm i përmbajtjes së tyre ndërmjet shtypit ose informacionit masiv. Në kushtet kur nuk provohet asnjë interes legjitim për të marrë këto akte, si dhe në rrethanat kur në brendinë e akteve ka të dhëna me karakter personal, refuzohet kërkesa”.*

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik, ankuesi pretendon se: *Dokumentacioni i kërkuar përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe për sa i përket anonimizimit të kompanive të hetuara në vendimin e dhënë, emri i tyre nuk është e dhënë personale pasi të dhënat e tyre publikohen sipas legjislacionit shqiptar në QKB.*

Në këto kushte ankuesi kërkon nga Komisioneri ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me Urdhrin nr. 150, datë 24.05.2018, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar. Gjatë inspektimit, përfaqësues të Autoritetit Publik kërkuan kohë për rivlerësimin e dhënies së informacionit të kërkuar.

Me shkresën nr. 2019/2 Prot., datë 31.05.2018, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke vënë në dispozicion të kërkuarit vendimin e pushimit të kërkuar në pikën e tretë të kërkesës, të anonimizuar sipas kërkesave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Nga përgjigja e Autoritetit Publik rezulton se kërkuarit nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar në pikën e parë dhe pikën e dytë të kërkesës.

Zyra e Komisionerit konstaton se arsyetimi i Autoritetit Publik lidhur me refuzimin e dhënies së informacionit të kërkuar në pikat 1 dhe 2 të kërkesës, nuk qëndron pasi kallëzimi i dërguar nga ana e FSDKSH-së në organin e Prokurorisë bazuar në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet si një detyrim për çdo nëpunës publik i cili në kuadër të ushtrimit të detyrës merr dijeni për një fakt që përbën vepër penale. Sa më sipër rrjedh logjikshëm që kallëzimi është një akt i hartuar dhe lëshuar nga autoriteti publik (dhe si i tillë përmbush kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”) i cili vë në lëvizje organin e prokurorisë. Për këtë arsye kallëzimi nuk mund të konsiderohet ekskluzivisht pjesë e procesit hetimor, dhe si i tillë t’i nënshtrohet vetëm dispozitave të Kodit të Procedurës Penale lidhur me ruajtjen e sekretit hetimor, proces ky që nis pas marrjes së kallëzimit nga organi i prokurorisë dhe vlerësimit të bërë nga ky i fundit lidhur me vijimin ose jo të procedimit penal.

Sa i përket korrespondencës së shkëmbyer nga Prokuroria me FSDKSH, duke qenë se kjo korrespondencë është ndërmarrë apo administrohet pranë FSDKSH-së (kjo e fundit gjithashtu konsiderohet autoritet publik në kuptim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”), përmbush kriteret për t’u konsideruar informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.*

Përsa i përket argumentit lidhur me konfidencialitetin e të dhënave të shoqërive të përfshira në hetim, Komisioneri vë në dukje se ato nuk përbëjnë të dhëna personale në kuptim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe për rrjedhojë nuk i nënshtrohen dispozitave të këtij ligji. Gjithashtu, edhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, duke pasur parasysh rolin e tyre brenda këtyre shoqërive si dhe faktin se të dhënat e tyre rezultojnë të publikuara pranë Regjistrat Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nuk i nënshtrohen procesit të anonimizimit. Nga administrimi i provave të paraqitura nga ankuesi konstatohet se në përputhje me nenin 328, të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për çështjen në fjalë rezultojnë të ketë një vendim pushimi. Si rrjedhojë, dhënia e informacionit nuk do të shkaktojë një dëm të qartë dhe të rëndë për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, apo të cënonte barazinë e palëve në proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, kufizime këto, të parashikuara në gërmat b) dhe dh) të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Lidhur me të dhënat e palëve të treta që mund të jenë përfshirë në çështjen objekt ankimi dhe që mund të përmenden në dokumentet objekt i kërkesës së ankuesit, informacioni lidhur me ta duhet të trajtohet në përputhje me nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe të vihet në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili përcakton se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kufizimet e pasqyruara në legjislacionin e zbatueshëm nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar dhe si rrjedhojë, Autoriteti Publik duhet të procedojë me dhënien e informacionit të kërkuar.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me pikat 1 dhe 2 të ankesës së Z. ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

### V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankimit nr. 851 Prot., datë 10.05.2018 të Z. , kundër Autoritetit Publik Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion, brenda datës 26.6.2018, të dokumentacionit të kërkuar sipas pikave 1 dhe 2 të kërkesës për informacion të datës 18.04.2018, dhe më konkretisht – 1. *Kopjen e kallëzimit të Drejtorisë Juridike të FSDKSH-së, dorëzuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Nr. 1821 Prot., datë 14.04.2016, me objekt Kallëzim të kryerjes së veprës penale të "Mashtrimit", "Mashtrimit në subvencione" dhe "Fallsifikim të Dokumenteve Shëndetësore". 2. Korespondencën e FSDKSH-së me Prokurorinë me shkresën Nr. 2708/1 Prot., datë 17.06.2016, në përputhje me pikën 6, të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe duke anonimizuar të dhënat e palëve të treta në përputhje me nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".*
3. Rrëzimin e ankesës për dokumentacionin e kërkuar në pikën 3 të kërkesës për informacion datë 10.05.2018, përkatësisht "Vendimin e pushimit të procedimit penal për kallëzimin e FSDKSH-së të dorëzuar me datë 14.04.2016 i cili iu vu në dispozicion kërkuarit gjatë procesit të hetimit administrativ të ndërmarrë nga Zyra e Komisionerit.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Ky vendim u shpall sot në datë 19.6.2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

